



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

V E N D I M

NR. 30/8, DATË 06 / 06 /2023

**PËR MIRATIMIN E STATUSIT “PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK
PARKU I ENERGJISË DIELLORE 190 MW DHE TË ERËS 636 MW, TROPOJË”, ME
SUBJEKT PROPOZUES ERALB INVEST 2 SH.P.K. ME NIPT/ NUIS M21823010B.**

Në mbështetje të Nenit 9, 14 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për Miratimin e Projekteve me Statusin “Projekt me Potencial Strategjik”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë,

VLERËSOI:

- Projekti i paraqitur është në përputhje me parashikimet e legjislacionit të investimeve strategjike, për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik”.
- Vlera e investimit të projektit me potencial strategjik “Parku i energjisë diellore 190 MW dhe të erës 636 MW, Tropojë” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 1,2 miliardë Euro.
- Projekti propozohet të realizohet nga subjekti Eralb Invest 2 shpk, me NUIS M21823010B.
- Projekti synon të realizojë një investim kompleks të përbërë nga një park i energjisë së erës me kapacitet 636 MW, ku do të instalohen 100 turbina ere si dhe nga një park fotovoltaiik me kapacitet 190 MW, ku do të instalohen 418 500 panele diellore.
- Subjekti ka ndarë projektin në faza, ku faza e parë do të fillojë me një fushatë matëse të burimeve të erës, faza e dytë do të përcaktojë gjurmën e saktë të projektit me vendndodhje të saktë për secilën turbinë dhe faza e tretë do të konsistojë në aplikimin për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’.
- Projekti synon të realizohet në një sipërfaqe prej 384.6 Ha dhe shtrihet në fshatrat Viçidol, Berishë, Luzhë dhe Paç, Bashkia Tropojë.
- Projekti është i pajisur me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 120, Datë 22.12.2022 “Për miratimin e dhënies në përdorim/qera të një siperfaqeje prej 40 ha për kërkime shkencore, me qëllim matjen e intensitetit të erës dhe ndërtimin e stacionit anemometrik në territorin pronë e Bashkisë Tropojë”, me një afat tre vjeçar.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Projekt me Potencial Strategjik” për projektin e investimit “Parku i energjisë diellore 190 MW dhe të erës 636 MW, Tropojë” propozuar nga subjekti Eralb Invest 2 shpk, me NUIS M21823010B.
2. Statusi “Projekt me potencial strategjik” i jepet projektit të investimit “Parku i energjisë diellore 190 MW dhe të erës 636 MW, Tropojë” propozuar nga subjekti Eralb Invest 2 shpk, për një periudhë 6 (gjashtë) mujore. Brenda kësaj periudhe, subjekti Eralb Invest 2 shpk duhet të aplikojë për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’.
3. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i aprovohen projektit me potencial strategjik janë:
 - a) Miratimi në parim i së drejtës për marrjen në përdorim të tokës për efekt “studim prone” për të krijuar mundësinë e kryerjeve së matjeve në terren sipas vendimit/ve të miratuar nga Këshillit Bashkiak;
 - b) Asistencë në përcaktimin e saktë të koordinatave të gjurmës së synuar për investim, specifikuar edhe koordinatat e sakta për secilën turbinë;
 - c) Asistencë në lidhje me mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor dhe administrativ, të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e projektit të investimit;
 - d) Ofrim i shërbimeve të nevojshme ndaj projektit me potencial strategjik, përfshirë shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, si dhe shërbime përfaqësimi tek autoritetet publike;
 - e) Asistencë e mëtejshme për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’.
4. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit me potencial strategjik “Parku i energjisë diellore 190 MW dhe të erës 636 MW, Tropojë” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit projekt me potencial strategjik të këtij projekti, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
5. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
6. Ngarkohet Bashkia Tropojë të dakordësojë me subjektin Eralb Invest 2 sh.p.k. koordinatat dhe sipërfaqen e zonës që Bashkia Tropojë ka të lirë dhe në dispozicion me qëllim që kjo sipërfaqe të përshtatet dhe përmbushë nevojat dhe kriteret për realizimin e këtij projekti.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Bashkia Tropojë, dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e zbatimit nga ana e autoriteteve publike të masave të përfshira në Planin e Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
9. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO

PLANI I VEPRIMIT
PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT ME POTENCIAL STRATEGJIK
PARKU I ENERGJISË DIELLORE 190 MW DHE TË ERËS 636 MW, TROPOJË

Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti me potencial strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza.

Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

1. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit

Ky plan veprimi për realizimin e projektit me Potencial Strategjik – “Parku i Energjisë Diellore 190 MW dhe të Erës 636 MW, Tropojë”, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv për Komitetin e Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

2. Hapat procedurale

Masat mbështetëse të kërkuara janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara nga Bashkia Tropojë	Vlerësimi i masës dhe të kostimit paraprak nga Bashkia Tropojë.	Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse (Të specifikohet dhe baza ligjore ku mbështetet procedura)	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Miratimi në parim i së drejtës për marrjen në përdorim të tokës për efekt “studim prone” për të krijuar mundësinë e kryerjeve të matjeve në terren sipas vendimit/ve të miratuar nga Këshilli Bashkiak;”.	Bashkia Tropojë	Të miratojë të drejtën për të marrë në përdorim tokën për efekt “studim prone”dhe t’i krijojë mundësinë subjektit të vendosë infrastrukturën e nevojshme për të realizur matjet përkatëse në terren.			
Asistencë në përcaktimin e saktë të koordinatave të gjurmës së synuar për investim	Bashkia Tropojë	Pas realizimit të studimeve përkatëse në zonë, Bashkia Tropojë në bashkëpunim me subjektin duhet të përcaktojë koordinatat e sakta të gjurmës së projektit. Pas saktësimit të gjurmës subjekti mund të aplikojë për përfitimin e statusit përfundimtar ‘Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë’.			

Marrja e licencave/ lejeve /autorizimeve pas përfitimit të statusit “Investitor strategjik, procedurë e asistuar”.	AIDA	Në referencë të legjislacionit të investimeve strategjike të asistohet subjekti duke u trajtuar me prioritet.			
--	-------------	---	--	--	--

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO